



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 80, datë 10.08.2020

**PËR**  
**MIRATIMIN E PRISHJES SË DETYRUAR TË GODINËS SË SHKOLLËS MESME**  
**TË BASHKUAR, ISMET NANUSHI, KULLE, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH,**  
**DURRËS, REKOMANDUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË, SI DHE**  
**HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PARAPRAKE E PRONAVE TË**  
**KËSAJ GODINE**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 297, datë 28.04.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Sukth, të Qarkut Durrës”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr.1537/1 prot., datë 02.07.2020, të Institutit të Ndërtimit Tiranë, me lëndë: “Komfirmim Akt ekspertizë” mbi bazën e raportit teknik mbi vlerësimin e shkallës së dëmtimit të objektit Shkolla e Mesme e Bashkuar Ismet Nanushi, Kulle, me porositet UNDP-në realizuar nga firma projektuese “ARKIMADE” shpk Tiranë, Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktivëve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

## KËSHILLI BASHKIAK

### V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës së shkollës Mesme të Bashkuar Ismet Nanushi, Kullë, që mban nr.5, të listës së transferimit, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave paluajtshme të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe rekomandohet të demolohet, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, të komfirmuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista paraprake e pronave të Njesisë Administrative Sukth, Bashkia Durrës, të pronës me nr. 5, me vendodhje në Kullë, Njësia Administrative Sukth, që i përket shkollës Mesme të Bashkuar Ismet Nanushi, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësia Administrative Sukth, në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me nr.5, me vendodhje Kullë, Sukth, Njësia Administrative Sukth, që i përket shkollës Mesme të Bashkuar Ismet Nanushi, që me VKM nr. 297, datë 28.04.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e godinës e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e godinës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkëpunojnë punën me UNDP për programin “EU4Schools” donacion i BE miratuar me vendim të KSHR që administron fondet për rindërtim, për të realizuar rindërtimin e godinës së shkollës Mesme të Bashkuar Ismet Nanushi, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të godinës, pas realizimit të rindërtimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Ligjore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 10.08.2020**






REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 738 / prot.  
4



Durrës, më 11.08.2020

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 80 datë 10.08.2020 “Për miratimin e prishjes së detyruar të godinës së shkollës së mesme të bashkuar “Ismet Nushi” Kulle, njësia administrative Sukth Durrës, rekomanduar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë si dhe heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake e pronave të kësaj godine”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

